

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi, kryetar, Tonka Berishaj dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Shaqë Curri, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.A. dhe F.A., që te dy nga fshati ..., komuna e Vitisë, për shkak të veprave penale-mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës të mbrojtësit të të akuzuarit F.A., av R.L., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.KR. nr. 83/2017 të datës 06.04.2017, në seancën e kolegjit 26 maj 2017, më mori këtë:

A K G J Y K I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit F.A., av R.L., kurse Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.KR. nr. 83/2017 të datës 06.04.2017, përkitazi me të akuzuarin F.A., vërtetohet.

II. Përkitazi me të akuzuarin B.A., aktgjykimi i përmendur mbetet i pa shqyrtuar sepse nuk ka ankesë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan me aktgjykimin P.KR. nr. 83/2017 të datës 06.04.2017, të akuzuarit B.A. dhe F.A., i ka shpall fajtor, secilin veç e veç, për shkak të veprës penale-mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK dhe i ka gjykuar me dënim me gjobë duke iu shqiptuar gjobën në shumë prej nga 250 € të cilën gjobë do ta paguajnë në afat prej tre (3) muajsh nga dita kur aktgjykimi ta merr formën e prerë. Po ashtu është vendosur që nëse të akuzuarit refuzojnë që ta paguajnë gjobën e shqiptuar ose nuk janë në gjendje ta paguajnë, atëherë gjykata në pajtim me të akuzuarit mund t'ia zëvendësojë dënimin me gjobë me punë në dobi të përgjithshme. Nëse të akuzuarit nuk pajtohen me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme, gjykata do të cakton një ditë burgim për çdo 20 € të gjobës së shqiptuar.

Të akuzuarit janë obligua që ti paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor prej 25 €, në afdat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi ta merr formën e prerë

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesa kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit F.A., av R.L., për shkak të vendimit për sanksionin penal me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit F.A., ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokurori i Shtetit, me parashtresën PPA/I.nr.227/17 datë 08.05.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit F.A., av R.L., të refuzohen si të pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, seancën e kolegjit e caktoi konformë dispozitës së nenit 390 par.1 të KPPK, për të cilën Prokurori i Apelit, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar sepse në rastin konkret kemi të bëjmë me aktgjykim me të cilin nuk është shqiptuar dënim me burgim, por të akuzuarve u është shqiptuar dënim me gjobë, prandaj, njoftimi i palëve nuk është i obligueshëm.

Gjykata e Apelit, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare konformë dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal në dëm të akuzuarit, atëherë Gjykata e Apelit të njëjtin e vlerësoi në pajtim me dispozitën e nenit 394 par. 1 të KPPK-së, sipas detyrës zyrtare dhe gjeti se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që kishin me kushtëzuar prishjen e tij.

Po ashtu, as gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj Gjykate, ngase në këtë drejtim nuk ka pasur ankesë e as që lejohet ankesa pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës dhe trupit gjykues është pajtuar me një pohim të tillë - neni 383 par. 2 të KPPK-së, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore.

Duke shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë. Në ankesë theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk I ka vlerësuar në masën e duhur rrethanat lehtësuese të cilat I ka konstatuar në anën e të këtij të akuzuari.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese që ishin në anën e tij dhe më pas i ka shqiptuar dënimin në përputhje me këto rrethana. Kështu, ajo gjykatë si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar sjelljet e të akuzuarit para dhe pas kryerjes së veprës penale, pranimin e fajësisë, moshën relativisht të re, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë veprë tjetër penale , se janë student. Rrethana renduese nuk gjeti. Vlerësimin e tillë të rrethanave për matjen e dënimit si të drejtë e pranon edhe Gjykata e Apelit, e cila gjen se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit, është në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, si kryerës dhe se me këtë dënim do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 41 të KPK-së. Në rrethana të këtylla nuk ekziston as asnjë arsye që

atij ti shqiptohet një dënim më i but, siç pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, aq më parë kur në ankesë nuk theksohen rrethana të tilla që do të justifikonin një dënim më të butë.

Për këtë arsye u deshtë që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Përkitazi me të akuzuarin B.A., aktgjykimi i i shkallës së parë mbetet i pa shqyrtuar sepse nuk pati ankesë.

Ngase u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.230/2017 datë 26 maj 2017

Procesmbajtës,

Shaqë Curri

Anëtarët e kolegjit:

Tonka Berishaj

Fillim Skoro

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi

Mbrojtësi i të akuzuarit Bledar Kusari, me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse ky aktgjykim bazohet në provë të papranueshme (neni 384 par. 1 nën par. 1.6 të KPPK-së) e që konsiston në atë se gjykata e shkallës së parë edhe për kundër faktit se ekspertizën e ekspertit financiar por edhe dëshmitë e 43 dëshmitarëve në cilat bazohet kjo ekspertizë, i ka shpall si prova të papranueshme për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore me rastin e dëgjimit të dëshmitarëve, aktgjykimin e bazon në këto prova që shihet edhe nga përshkrimi faktik në dispozitiv të aktgjykimit kur i referohet shumës së dëmit të shkaktuar dhe veprimeve të akuzuarit. Se gjykata e shkallës së parë e ka bazuar aktgjykimin në prova të papranueshme, sipas mbrojtjes, vërtetohet edhe nga konstatimi i kësaj gjykate kur palën e dëmtuar e udhëzon në kontest civil sepse lidhur me lartësinë e dëmit nuk ka prova konkrete e as ekspertizë financiare. Po ashtu, pretendon se edhe nga konstatimi i gjykatës në faqen 4, pasusi 2, reshti 3 ku thuhet: ''si dhe mesazhet e nxjerra nga komunikimet telefonike, lidhur me veprimet e të akuzuarit'', rezulton se aktgjykimi është i mbështetur në prova të papranueshme, sepse në shkresa të lëndës fare nuk ka urdhëresë për zbatimin e masave të fshehta ndaj të akuzuarit, në këtë rast përgjim të telekomunikimeve përfshirë edhe tekstet e mesazheve ose mesazhet tjera elektronike që paraqet shkelje të nenit 91 par. 2 nën par. 2.8 të KPPK-së. Pastaj ka theksuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPK-së (shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPK-së), sepse në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë dhënë arsyet për çdo pikë të aktakuzës. Pra, sipas tij mungojnë arsyet në bazë të cilave gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar faktet nga të cilat rezultojnë elementet e veprës penale për të cilat i akuzuari është shpallur fajtor.

Po ashtu pretendon se gjatë procedurës penale gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e dëgjimit të dëshmitarit Lejti Zenkovski, respektivisht leximit të procesverbalit (shkelje e dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën par. 2.1 të KPPK-së), sepse i dëmtuari gjatë marrjes në pyetje të këtij dëshmitari vazhdimisht e ka penguar duke e sugjeruar se si të përgjigjet në pyetje dhe në këtë mënyrë direkt ka ndikuar në përgjigjet e tij që këtë deklaratë e bënë të papranueshme sipas nenit 155 par. 1 nën par. 1 dhe 154 par. 5 të KPPK-së. Pastaj, gjykata edhe përkundër kundërshtimit të mbrojtjes e ka lexuar deklaratën e dëshmitares Dardane Shyti, e cila ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt e në aktgjykim është konstatuar se leximi është bërë me pajtimin e palëve. Gjithashtu, konstatimi i gjykatës se janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve Kastriot dhe Valon Kërleshi, nuk i përgjigjet përmbajtjes të procesverbalit sepse këta dëshmitarë kanë dëshmuar në shqyrtimin gjyqësor.

Duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore, por edhe sipas detyrës zyrtare konform nenit 394 par. 1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit, gjen se ky aktgjykim është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nën par.1.8, 1.12, par. 2 nën par. 2.1 të KPPK-së, sepse aktgjykimi i ankimuar bazohet në prova të papranueshme, nuk është përpiluar në pajtim me dispozitën e nenit 370 të këtij Kodi dhe se gjatë procedurës penale gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e leximit të deklaratës të dëshmitares Dardane Shyti, nga këto arsye:

-Së pari, sa u përket pretendimeve të mbrojtësit të të akuzuarit Bledar Kusari - se aktgjykimi i ankimuar mbështetet në prova të papranueshme, kjo Gjykatë gjen se këto pretendime janë të bazuara dhe se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384, par.1, nënpar.1.8 të KPPK-së meqë i njëjti mbështetet në prova të cilat paraprakisht gjykata e shkallës së parë i ka shpall të papranueshme. Në përshkrimin faktik si në dispozitiv të aktgjykimit ashtu edhe në arsyetim konstatohet: "...duke përvetësuar shumën prej 20.000 €, ashtu që gjatë veprimtarisë së tij nga depoja e kësaj organizate ka tërhequr artikuj të ndryshëm pa evidentim përkatës në librat dalëse, duke i shitur nëpër firma të ndryshme me të cilat ka afruar në tërë territorin e Kosovës, duke prezantuar fatura fiktive dhe duke i ngarkuar ato me borxhe të caktuara ndaj firmës NSHT "Ariani", ndërsa ekspertizën financiare për konstatimin e këtyre rrethanave si dhe deklaratat e 43 dëshmitarëve në të cilat bazohet ekspertiza në shqyrtimin gjyqësor të dt. 03.07.2012, me aktvendim janë shpallur prova të papranueshme e në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka dhënë arsye se në bazë të cila provave i ka vërtetuar këto fakte.

Sipas dispozitës së nenit 370 par 7 të KPPK-së (i vjetri 396 par. 7), gjykata në aktgjykim paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërtënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e zbatimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij. Ndërkaq sipas paragrafit 4 po të njëjtës dispozitë

parashikohet se dispozitivi i aktgjykimit - kur i akuzuari është shpallur fajtor - përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara me nenin 365 par. 1 nën par. 1.1 të KPPK-së, që parashikon se aktgjykimi me të cilin i akuzuari shpallet fajtor përmban faktet dhe rrethanat që përmbajnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit fare nuk ka dhënë arsye: se si është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar, cilët artikuj i ka përvetësuar, kush ka qenë i ngarkuar me mbajtjen e evidencës, cilave firma iu ka shit mallin, cilat fatura i ka prezantuar, kënd ka ngarkuar me borxhe, sa është lartësia e borxhit, sa ka pranuar dhe nga kush si dhe fakti se kujt ia ka dorëzuar parat. Se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar këto rrethana e as që ka dhënë arsye për to shumë qartë shihet nga udhëzimi juridik që i referohet palës së dëmtuar ku taksativisht thekson:” Pala e dëmtuar NSHT ‘‘Ariani’’ dhe të dëmtuarit tjerë eventual, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në procedurë kontestimore konform nenit 112 të KPPK-së, nga se nuk është arrit që gjatë shqyrtimit gjyqësor të përcaktohet kërkesa e saktë, në bazë të dëshmive përkatëse e as të ekspertizës financiare për dëmin e shkaktuar’’. Prandaj mungesa e këtyre fakteve sidomos kur kemi parasysh faktin se nga lartësia e shumës së dëmit të shkaktuar varet edhe cilësimi juridik i veprës penale nga të cilat fakte varet edhe zbatimi i dispozitës konkrete të Kodit Penal, në këtë rast nenit 339 par.3 lidhur me par.1 të KPPK-së, që dispozitivin e aktgjykimit e bëjnë të paqartë dhe të pakuptueshëm dhe juridikisht të paqëndrueshëm.

-Së dyti, kontrolli dhe leximi i SMS-ve, por edhe përgjimi i bisedave telefonike të akuzuarit është bërë pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake në kundërshtim me dispozitën e nenit 258 par. 1 nën par. 1 pika 4 të KPPK-së (i Riu neni 91 par. 1), i cili parashikon mundësin e regjistrimit të bisedave telefonike sipas urdhrimit të Prokurorit Publike, mirëpo, sipas paragrafit 2 nën par.2 dhe 4 të të njëjtës dispozitë parashihet se monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private dhe përgjimin e telekomunikimeve mund ta urdhërojë vetëm gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesës së Prokurorit Publik. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e mbështet edhe në këto prova ashtu që në faqen 4, pasusi 2, reshti 3 konstaton:”si dhe mesazhet e nxjerra nga komunikimet telefonike, lidhur me veprimet e të akuzuarit’’. Prandaj mbështetja e aktgjykimit të shkallës së parë në këto prova-transkriptet e telekomunikimeve dhe SMS-vë në fjalë të siguruara në mënyrë kundërligjore, në kundërshtim me dispozitën e nenit 257 par. 3 lidhur me nenin 249 të KPPK-së(i vjetri neni 153 dhe 154 të KPPK-së), parashikohet se provat të cilat janë marrë në kundërshtim dhe në mënyrë jo të ligjshme nga policia, Prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritarë, konsiderohen prova të papranueshme dhe mbi këto prova gjykata nuk mund ta mbështesë vendimin e saj, andaj edhe paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 nënpar.1.8 të KPPK-së.

-Së treti, nga shikimi i procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të dt.04.10.2012, vërtetohet se gjykata e shkallës së parë e ka lexuar deklaratën e dëshmitares, Dardane Shyti edhe pse mbrojtësi i të akuzuarit e ka kundërshtuar një gjë të tillë nga se e njëjta e ka pranuar ftesën në mënyrë të rregullt e gjykata nuk jep arsyetim se cila është arsyeja e refuzimit të kërkesës. Dispozita e nenit 368 par. 1 të KPPK-së (i Riu 338 par.1), përveç tjerash

parashikon që dëshmia e dëshmitarit sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohet kur personi i marr në pyetje nuk mund të gjendet ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur, kur dëshmitarët ose ekspertet pa bazë ligjore nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor ose kur palët pajtohen që, në vend të marrjes së drejtpërdrejt në pyetje të dëshmitarit. Mirëpo, me rastin e leximit të deklaratës të dëshmitares Dardane Shyti, në shqyrtimin gjyqësor gjykata në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor nuk ka konstatuar ndonjë të rrethanat e parashikuara me këtë dispozitë, por vetëm konstatimi se prokurori dhe pala e dëmtuar janë pajtuar për leximin e deklaratës dhe ashtu si u tha edhe më lartë kundërshtimin e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa në arsyetimin e aktgjykimit në faqen 3, pasusi i tretë konstaton se dëshmitë e dëshmitarëve janë lexuar konform nenit 368 të KPPK-së, me pajtimin e të dy palëve, kështu që për faktet vendimtare ka kundërthënë të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e procesverbalit për deklarimet e dhëna në procedurë dhe vet këtij procesverbalit, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1 nën par. 1.12 dhe par. 2 nën par. 1.1 të KPPK-së sepse gjykata e shkallës së parë gjatë procedurës penale nuk i ka zbatuar dispozitat ligjore me rastin e leximit të deklaratës të dëshmitares Dardane Shyti, si me të drejtë pretendon mbrojtësi i të akuzuarit.

Nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të dt. 02.11.2012, rezulton se i dëmtuari Urim, ka ndërhy gjatë deklarimit të dëshmitarit Lejti Zenkovski për çka kryetari i trupit gjykues edhe e ka përjashtuar të dëmtuarin nga seanca, mirëpo në vazhdim të seancës dëshmitari ka pasur mundësi që të përgjigjet në pyetje të Prokurorit dhe mbrojtjes pa pengesa, kështu që kjo Gjykatë pretendimet ankimore lidhur me këtë dëshmitar i vlerësoi si të pabazuara.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetimi jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljet e ligjit penal, Gjykata e Apelit, gjen se pretendimet ankimore në këtë drejtim po ashtu janë të bazuara, nga se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cekura si më lartë janë ngushtë të ndërlidhura edhe me vërtetimi jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe që pa dyshim drejtpërdrejtë ka ndikuar edhe në aplikimin e gabuar të ligjit penal dhe si pasojë e kësaj është shkelur edhe ligji penal.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet ti eliminojë vërejtjet e përmendura si më lartë e sidomos ato që kanë të bëjnë me prova të papranueshme dhe pas administrimit të provave të njëjtat ti vlerësojë në pajtim me nenin 361 të KPPK-së (i vjetri neni 387) dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave duke marr parasysh edhe pretendimet tjera nga ankesat e mbrojtësit të të akuzuarit, të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga çka u tha më lartë, e konformë dispozitës së nenit 402 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PAKR.nr.41/2013 më 17.09.2013

Procesmbajtës,

Shaqë Curri

Anëtarët e kolegjit,

Tonka Berishaj_____

Abdullah Ahmeti_____

Kryetari i kolegjit,

Xhevdet Abazi